4	Shkolla KOSINE	437368	437368	0
5	Njesia Administrative PETRAN	288794	288794	0
6	Shkolla PETRAN	160156	160156	0
7	Njesia Administrative FRASHER	462308	462308	0
8	Shkolla "Sami FRASHERI"	1813757	1813757	0
9	Shkolla "Nonda BULKA"	3029606	3029606	0
10	Shkolla "Meleq GOSNISHTI"	5822536	5822536	0
11	Qendra kulturore	14000	14000	0
12	Kopesht,cerdhe,konvikt etj	1533930	1533930	0
13	Rruga Ura	179500	179500	0
14	Pastrim,Gjelberimit	980335	980335	0
	SHUMA(218)	18588202	18588202	0

PERMBLEDHESE E MATERIALEVE TE DEMTUARA PËR

(Instalime
teknike,pajisje,instrumente
dhe vegla)

LLOGARINË 214

Nr	EMERTIMI	Vlera fillestare në lekë	Amortizimi	Vlera neto në lekë
1	BASHKIA	11316165	11316165	0
2	Njesia Administrative PISKOVE	232578	232578	0
3	Shkolla Piskove	1008936	1008936	0
4	Njesia Administrative PETRAN	567432	567432	0
5	Shkolla PETRAN	170750	170750	0
6	Njesia Administrative FRASHER	70312	70312	0
7	Njesia Administrative ÇARSHOVE ,shkolla	1024533	1024533	0
8	Kopesht,cerdhe,konvikt etj	129240	129240	0
9	Rruga Ura	13000	13000	0

Sheshi "Abdyl Frashëri, tel.+35581322254,e-mail:info@bashkiapermet.gov.al



10	Pastrim,Gjelberimit	523100	523100	0
	SHUMA(214)	15056046	15056046	0

Përveç përmbledhëses së mësipërme ju bëjmë me dije :

1.Rezultojnë të vjedhura në Shkollën “Sami Frashëri” materialet:

Llogaria (218)

Nr	EMERTIMI	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera fillestarë në lekë	Amortizimi	Vlera neto në lekë
1	Lap top	copë	3	58740	176220	176220	0
2	Fotokopjues	copë	1	53000	53000	53000	0
3	Skaner CANON	copë	1	10002	10002	10002	0
	TOTALI (218)				239222	239222	0

Sipas shkresë Nr.6 datë 12.01.2009 së ish drejtorit të Gjymnazit “Sami Frashëri “Z Flamur Dosti konstatohet se objektet e mësipërme janë vjedhur. Oë prej asaj periudhe nuk kanë dalë përgjegjësit dhe nuk është ndjekur ndonjë procedurë e mëtejshme lidhur me këto zëra.

2.Rezultojnë të vjedhura materialet e Repertitorit te ish-Vila:

Llogaria (327)

Në lekë

Nr	EMERTIMI	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
1	Përsëritës televiziv	copë	2		
	TOTALI 327				

Llogaria(218)

Nr	EMERTIMI	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera fillestare në lekë	Amortizimi	Vlera nëto në lekë
1	Përsëritës televiziv	copë	1	78300	78300	78300	0
2	Aparat Dixhital	copë	1	120000	120000	120000	0
	TOTALI (218)				198300	198300	0

Sheshi “Abdyl Frashëri, tel.+35581322254,e-mail:info@bashkiapermet.gov.al



Sipas proces verbaleve të mbajtura respektivisht në datë 24.07.2018 dhe në datë 05.03.2021 ishte konstatuar nga Ish punonjësit me përgjegjësi materiale dhe specialistët e fushës se baza materiale e mësipërme është vjedhur dhe është njoftuar Komisariati i Policisë por nuk janë marrë masa të mëtejshme .

3.Një pjesë e bazës materialeve të repertitorëve janë transferuar në RTSH kjo sipas të dhënave të ish-punonjësit të RTSH-së Z.J.Jovani por nuk janë kryer sistemimet në kontabilitet.

Në lekë

Nr	EMERTIMI	Llogaria 214	Llogaria 218	Llogaria 327
1	Nj.Adm.Petran/përforcuesi Lipivan	297000		
2	Nj.Adm.Piskovë/përforcuesi Borockë		276965	1500
3	Nj.Adm.Çarshovë/Repertitori	811600		79500
	TOTALI (218)	1108600	276965	81000

4.Rezulton se në inventarët e shkollës Kosinë ,klasa e internetit mungojnë këto zëra që prej kohës viti 2008-2009 (por nuk ka dokumentacion bashkëshoqërues).Që prej vitit 2015 që ish Njësitë Administrative janë transferuar e deri më tani nuk është vijuar ndonjë procedurë.

Llogaria (214)

Në lekë

Nr	EMERTIMI	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera fillestare në lekë	Amortizimi	Vlera neto në lekë
1	Kompjuter mësuesi	copë	1	49371	49371	49371	0
2	Kompjuter nxënësi	copë	8	44339	354712	354712	0
3	Sëiten 16 prot	copë	1	4616	4616	4616	0
4	Lazer printer	copë	2	14601	29202	29202	0
5	Skaner	copë	1	4723	4723	4723	0
6	UPS	copë	9	5367	48303	48303	0
7	RACK 7 U	copë	1	5367	5367	5367	0
8	Instalim	copë	1	47995	47995	47995	0
9	Karrige rrotulluse	copë	8	4106	32848	32848	0
10	Monitor + truri	copë	1	98000	98000	98000	0
	TOTALI (214)				675137	675137	0

Siç shihet edhe klasifikimi i llogarive ekonomike nuk është kryer i saktë sipas legjislacionit në fuqi nga ish administrata e Njësive Administrative (ish-Komunat).

Pas verifikimit ,komisioni konstatoi se inventarët e mësipërm nuk janë më të përdorshëm dhe ka propozuar :

Sheshi "Abdyl Frashëri, tel.+35581322254,e-mail:info@bashkiapermet.gov.al

- 1.Nxjerrjen e tyre jashtë përdorimit dhe heqjen e tyre nga regjistrat kontabël.
- 2.Dorëzimin për shkatërrim/riciklim/shitje si mbetje (sipas rastit).

KRYETAR I BASHKISË
Alma HOXHA



Sheshi "Abdyl Frashëri, tel.+35581322254,e-mail:info@bashkiapermet.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

PROJEKT VENDIM
NR. _____ DATË _____

PËR

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.96,DATË 27.11.2024,"PËR MIRATIMIN E TAKSAVE DHE
TARIFAVE VENDORE,BASHKIA PËRMET,VITI 2025".**

Në mbështetje të nenit 54, shkronja "f", të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore", Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar , Ligjit Nr. 9920 datë 19.5.2008 "Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë ", i ndryshuar , Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" , i ndryshuar, VKM nr.132 datë 07.03.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksë".Paketës Fiskale të vitit 2025,miratuar me vendim nr.96,datë 27.11.2025, Këshilli i Bashkisë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

VENDOSI:

1.Të miratojë nivelin e taksës së fjetjes në hotel për Bashkinë Përmet, sipas kategorizimit të numrit të shtretërve si më poshtë:

- Hotel,bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese që në strukturat e tyre kanë nga 1- 10 shtretër taksa e fjetjes ne hotel do të llogaritet për 30 netë fjetje për cdo shtrat.
- Hotel,bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese që në strukturat e tyre kanë nga 11- 20 shtretër taksa e fjetjes ne hotel do të llogaritet për 45 netë për cdo shtrat.
- Hotel,bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese që në strukturat e tyre kanë nga 21e lartë shtretër taksa e fjetjes ne hotel do të llogaritet për 60 netë për cdo shtrat.

2.Të gjitha subjektet akomoduese e kanë të detyrueshëm të bëjnë deklarinimin për numrin e shtretërve dhe rregjistrin të fjetjes në strukturë dhe ta paraqesin atë në Bashkinë Përmet për t'u sekretuar me vulë origjinale të Bashkisë.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Tatim Taksave,Aseteve dhe licencave pranë Bashkisë Përmet ,Njësitë Administrative.

4.Ky vendim hyn në fuqi në menjëherë .

KRYETAR I BASHKISË

Alma HOXHA



RELACION

Në mbështetje të nenit 54, shkronja "F", të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore", Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar, Ligjit Nr. 9920 datë 19.5.2008 "Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, VKM nr.132 datë 07.03.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës", Paketës Fiskale të vitit 2025, miratuar me vendim nr.96, datë 27.11.2025, si dhe nisur nga fakti se një pjesë e subjekteve akomoduese nuk ka derdhur taksën e fjetjes në hotel për vitin 2025, ose dhe ata që e kanë derdhur nuk kanë bërë deklarin e sakt konform ligjit në fuqi, kërkojmë nga Këshilli i Bashkisë të miratojmë nivelet për taksën e fjetjes në hotel sipas kategorizimit të numrit të shtretërve si më poshtë:

- Hotel, bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese që në strukturat e tyre kanë nga 1- 10 shtretër taksa e fjetjes ne hotel do të llogaritet për 30 netë fjetje për cdo shtratë.
- Hotel, bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese që në strukturat e tyre kanë nga 11- 20 shtretër taksa e fjetjes ne hotel do të llogaritet për 45 netë për cdo shtratë.
- Hotel, bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese që në strukturat e tyre kanë nga 21 e lartë shtretër taksa e fjetjes ne hotel do të llogaritet për 60 netë për cdo shtratë.

Të gjitha subjektet akomoduese e kanë të detyrueshëm të bëjnë deklarin e rregjistrimit të fjetjes në strukturë dhe ta paraqesin atë në Bashkinë Përmet për t'u sekretuar me vulë origjinale të Bashkisë.

Nga punonjësit e sektorit të Tatim Taksave, Aseteve dhe Licencave, është punuar maksimalisht për evidentimin e subjekteve që kanë struktura akomoduese, me dalje në terren, identifikim nëpërmjet faqes booking etj, kanë takuar subjekte të këtyre strukturave, kanë kërkuar rregjistrat e tyre dhe nuk i kanë paraqitur. Po kështu u kanë kërkuar të paraqiten pranë sektorit të tyre për të bërë deklarin për numrin e shtreterve dhe fjetjet dhe nuk janë paraqitur. Realizimi i taksës së fjetjes në hotel për periudhën raportuese është 186 290 lekë ose në përqindje me planin vjetor 37,2%.

Në datën 30 Shtator bëm një takim me të gjitha subjektet që kanë struktura akomoduese në qytet dhe njësitë administartive, në të cilin kishim të pranishëm dhe anëtar të Këshillit Bashkiak. Në takim ishin të pranishëm vetëm subjekte që kanë paguar taksën e fjetjes në hotel për 6 mujorin e parë 2025.

Të ndodhur para një fakti të tillë kërkojmë mbështetjen dhe mirëkuptimin tuaj për këtë vendimarrje. Ju faleminderit !


Përgjegjësi i Sektorit të Tatim Taksave

Drejtori i Zhvillimit Ekonomik

Dorjan Metko



Etleva Myftari



Sheshi "Abdyl Frashëri", tel.+35581322254, e-mail:info@bashkiapermet.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

PROJEKT- VENDIM

Nr. _____ Datë _____ 2025

PËR

“MIRATIMIN NË PARIM TË PËRCAKTIMIT TË VENDIT TË PËRKOHSHËM TË GRUMBULLIMIT DHE ASGJËSIMIT TË KADAVRAVE”

Bazuar në ligjin Nr. 139, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar; Nenin 54 të ligjit Nr. 10 465, datë 29.9.2011, “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr. 475, datë 30.7.2021, “Për Bashkëpunimin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore me Shërbimin Veterinar, në mbështetje dhe të VKM Nr.433/2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike ,sipas listave të inventarit,dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive”,e ndryshuar si dhe bazuar në shkresën Nr.245/7 prot. datë 02.06.2025 të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural,Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve,Drejtorisë së Veterinarisë,dhe shkresës Nr.602 prot. datë 16.06.2025 të Drejtorisë Rajonale të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve Vlorë me qëllim të përcaktimit të grumbullimit,eliminimit dhe asgjësimit apo krematorizimit të kadavrave. Në këtë kuadër Sektori i Emergjencave Civile,Mbrojtjes së Qytetarit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanistikës,Planifikimit të Territorit dhe Sektorit Juridik kanë bërë përcaktimin e vendgroposjes në pasurinë Nr.579 zk.3967 N.B Përmet 1, sipas studimit të bërë nga specialisti veterinar pranë Bashkisë Përmet si dhe bazuar në relacionin e paraqitur e me propozim të Kryetarit të Bashkisë ,

VENDOSI:

1. Përcaktimin e vendit të përkohshëm të grumbullimit dhe asgjësimit të kadavrave në Zonën Kadastrale 3967 N.B Përmet 1, pjesë e pasurisë Nr.579 në pronësi të Bashkisë Përmet sipas VKM Nr.433 dt.08.06.2016.
2. Pozicionimi i vendit të grumbullimit dhe asgjësimit të kadavrave është sipas hartës së marrë nga gjeoportali kombëtar ASIG bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Per zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria Urbanistikës,Planifikimit të Territorit, Sektorit Juridik e Prokurimeve, Sektori i Emergjencave Civile,Mbrojtjes së Qytetarit dhe Mjedisit.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit Nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, (i ndryshuar).

KRYETARI I BASHKISË
Alma HOXHA

[Signature]



530318.584
4456590.441

531554.784
4456590.441




530318.584
4456590.441

531554.784
4456590.441

<https://geoportal.asig.gov.al> ofron të dhëna
gjeohapësinore të ofruara nga autoritetet publike
përgjegjëse.

Përgjegjësia për saktësinë e të dhënave është e
autoritetit publik që i ka krijuar ato.



Legjenda

Parcelat

Kadastrale
(AI BSCAD)

Shtresë

Razë

Parcelat

Parcelat

Parcelat

Parcelat

Parcelat

Parcelat

Parcelat

Parcelat

Parcelat

Parcelat

Parcelat

Parcelat

Sistemi koordinativ: KRGJSH

Projektimi: KRGJSH



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET



RELACION
PËR

“MIRATIMIN NË PARIM TË PËRCAKTIMIT TË VENDIT TË PËRKOËSHËM TË GRUMBULLIMIT DHE ASGJËSIMIT TË KADAVRAVE”

Përmet, më . . . 2025

Bazuar në ligjin Nr. 139, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar; Nenin 54 të ligjit Nr. 10 465, datë 29.9.2011, “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr. 475, datë 30.7.2021, “Për Bashkëpunimin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore me Shërbimin Veterinar, në mbështetje dhe të VKM Nr.433/2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike ,sipas listave të inventarit,dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive”,e ndryshuar si dhe bazuar në shkresën Nr.245/7 prot. datë 02.06.2025 të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural,Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve,Drejtorisë së Veterinarisë,dhe shkresës Nr.602 prot. datë 16.06.2025 të Drejtorisë Rajonale të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve Vlorë me qëllim të përcaktimit të grumbullimit,eliminimit dhe asgjësimit apo krematorizimit të kadavrave. Në këtë kuadër Sektori i Emergjencave Civile,Mbrojtjes së Qytetarit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanistikës,Planifikimit të Territorit dhe Sektorit Juridik kanë bërë përcaktimin e vendgroposjes në pasurinë Nr.579 zk.3967 N.B Përmet 1, sipas studimit të bërë nga specialisti veterinar pranë Bashkisë Përmet.

Eliminimi i kadavrave me groposje është domosdoshmëri, pasi ato përbëjnë një rrezik të konsiderueshëm infeksioni për njerëzit dhe kafshët, sidomos në sëmundje zoonotike infektive ku përhapja e infeksionit është shumë e madhe. Kafshët e ngordhura ose të therura nga sëmundje ngjitëse paraqesin rrezik të lartë për ndotjen e mjedisit dhe përhapjen e sëmundjeve nëpërmjet ujërave nëntokësore dhe ajrit. Gjithashtu, edhe kafshët e braktisura apo të egra, për shkak të vdekjes natyrale ose sëmundjeve, janë burim potencial infeksioni. Për këtë arsye, trajtimi dhe groposja e kontrolluar e tyre është domosdoshmëri, në përputhje me kërkesat e ligjit dhe aktet nënligjore në fuqi. Në përputhje me VKM nr.475, datë 30.07.2021, “Për bashkëpunimin e njësive të vetëqeverisjes vendore me Shërbimin Veterinar”, nevojitet që periodikisht të monitorohet territori i bashkisë dhe të përcaktohen vendet e sigurta për groposjen e kadavrave, për të shmangur çdo rrezik ndotjeje apo kontaminimi të ujërave dhe tokës.

Përcaktimi i këtyre vendeve bëhet në bashkëpunim me njësitë administrative dhe me udhëzimet teknike të sektorit veterinar të Bashkisë Përmet, bazuar në kriteret që garantojnë:

- a) largësi nga burimet e ujit të pijshëm;
- b) terren të përshtatshëm për groposje;
- c) mbulim të sigurt për të shmangur përhapjen e infeksioneve apo aromave;
- d) qasje të mundshme për transportin e kadavrave.

Grumbullimi dhe transportimi i kadavrave do të kryhet me mjete të përshtatshme, në bashkëpunim me sektorin rajonal të AKVMB Gjirokastrë dhe në prani të veterinerit zyrtar. Gjatë këtij procesi mund të hasen vështirësi që lidhen me statusin pronësor të tokave të përzgjedhura, si dhe me nevojën për ndërhyrje të Bashkisë për plotësimin e kushteve teknike (gërmime, rrethime, ndërtim groposjesh, etj.). Për këtë arsye, kërkohet mbështetje financiare dhe logjistike nga strukturat përkatëse të Bashkisë Përmet për realizimin e këtij procesi në përputhje me standardet ligjore dhe higjieno-sanitare.

 Bashkia Permet ka ndërmarrë hapat për përcaktimin e një vendi të posaçëm për grumbullimin dhe asgjësimin e tyre.

Pas verifikimeve të kryera nga strukturat përkatëse të Bashkisë, në bashkëpunim me dhe Zyrën Veterinare të zonës, është konstatuar nevoja emergjente për një vend të sigurt dhe të përshtatshëm, ku të kryhet asgjësimi i kadavrave të kafshëve në mënyrë të kontrolluar dhe sipas standardeve mjedisore dhe shëndetësore.

Vendndodhja e propozuar për këtë qëllim ndodhet në Zonën Kadastrale 3967 N.B Permet 1, pjesë e pasurisë Nr.579 e cila është në pronësi të Bashkisë Permet bazuar në VKM Nr.433/2016, e cila plotëson kriteret për:

1. Distanca të mjaftueshme nga qendrat e banuara dhe burimet ujore;
2. Akses të lehtë për mjetet e transportit;
3. Mundësi për kryerjen e procedurave të asgjësimit sipas udhëzimeve veterinare.

Ky përcaktim do të mundësojë:

1. Trajtimin higjieno-sanitar të rasteve të ngordhjeve apo epidemive të kafshëve;
2. Mbrojtjen e shëndetit publik dhe të mjedisit;
3. Respektimin e legjislacionit në fuqi mbi mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të kafshëve.

Në bazë të sa më sipër, i propozohet Këshillit Bashkiak Permet miratimi i vendimit: "Për Miratimin në Parim të Përcaktimit të Vendi të Përkohshëm të Grumbullimit dhe Asgjësimit të Kadavrave".

Konceptoi :

E.Gurra (Specialist Veterinar)

E.Kushe (Përgj.Spektori Juridik)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

P/VENDIM

Nr. ____ Date ____/____/____

PËR
MIRATIMIN E PLANI VENDOR PËR EMERGJENCAT CIVILE BASHKIA PËRMET
2025-2028

Bazuar në Ligjin, Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligji Nr. 45/2019, datë 18.07.2019, “Për mbrojtjen civile”, Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023-2030, Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqësitë në Nivel Qendror, VKM Nr. 807, datë 28.12.2023 “Plani Kombëtar për Emergjencat Civile” me propozim të Kryetarit të Bashkisë :

VENDOSI:

1. Të miratojë “Plani Vendor për Emergjencat Civile – Bashkia Përmet 2025-2028”.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen të gjitha drejtoritë dhe strukturat e bashkisë Përmet.
3. Ky vendimhyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR I BASHKISË
ALMA HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA E PËRMET

RELACION

PËR

MIRATIMIN E PLANIT VENDOR PËR EMERGJENCAT CIVILE

Projektvendimi "Për miratimin e Planit Vendor për Emergjencat Civile", në mbështetje të pikës 1, "Bashkitë janë përgjegjëse për garantimin e mbrojtjes civile, në nivel vendor dhe administrimin e strukturave përkatëse sipas mënyrës së përcaktuar me ligj", të nenit 29, "Funksionet e bashkive në fushën e sigurisë publike," të ligjit 139/2015 për " Vetëqeverisjen Vendore"; të pikës 6, " Plani vendor për emergjencat civile miratohet me vendim të këshillit bashkiak dhe duhet harmonizuar me Planin Kombëtar të Emergjencave Civile dhe planet për emergjencat civile të bashkive fqinje" të nenit 14, " Planet për emergjencat civile" të ligjit nr. 45, datë 18.07.2019 "Për mbrojtjen civile", është një nga dokumentet kryesore të Bashkisë Përmet në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile.

Sipas përkufizimit të ligjit 45/2019 "Për mbrojtjes civile", "Plani për emergjencën civile" është plani për përgatitjen, parandalimin, mbrojtjen, shpëtimin dhe ndihmën në rast të një fatkeqësie natyrore ose të një fatkeqësie tjetër, i hartuar në bazë të vlerësimit të risqeve dhe të gjetjeve të ekspertëve.

Plani për emergjencat civile u hartua bazuar në strategjitë për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, dokumentet e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë, kapacitetet e mbrojtjes civile, gjetjet e reja të ekspertëve, si edhe përvojat e fituara në menaxhimin e fatkeqësive në territorin e Bashkisë Përmet

Plani vendor për emergjencat civile i Bashkisë Përmet është i harmonizuar me Planin Kombëtar të Emergjencave Civile, i miratuar me VKM Nr.807, datë 28.12.2023 dhe metodologjisë për hartimin e planeve të emergjencave civile, sipas modulit të trajnimeve bazë të mbrojtjes civile për strukturat civile në nivel bashkie të zhvilluara nga AKMC përgjatë vitit 2024 dhe 2025

Për përgatitjen e planit, nga grupi i punës i ngritur me urdhër nr.155 datë 05.05.2025 të kryetarit të bashkisë, u shfrytëzuan të gjitha dokumentet ekzistuese dhe përvojat e ekspertëve dhe grupeve të tjera të interesit. Nën vërejtje faktin se plani u bazua edhe në gjetjet sikurse është në koherencë me dokumentin e vlerësimit të riskut të fatkeqësive dhe me strategjinë vendore të ZRF dhe MC, çka përbën edhe rastin më të mirë për përgatitjen siç duhet të një dokumenti të tillë.



Synimet e Planit Vendor për Emergjencat Civile (PVEC):

PVEC synon pikësepari të mbrojë jetët njerëzore dhe të garantojë sigurinë dhe mirëqenien e banorëve gjatë emergjencave, duke minimizuar dëmtimin e pronës dhe infrastrukturës, trashëgimisë kulturore, gjësë së gjallë, komuniteteve dhe mjedisit. Këto synime janë në funksion të garantimit të vazhdimësisë duke ruajtur shërbimet dhe funksionet thelbësore gjatë dhe pas emergjencave apo fatkeqësive që mund të prekin bashkinë. PVEC i Bashkisë Përmet ka si synim kryesor, rritjen e aftësisë ripërtëritëse të komuniteteve vendore për të përballuar emergjencat dhe fatkeqësitë, si dhe garantimin e rimëkëmbjes së këtyre komuniteteve vendore pas fatkeqësive.

Objektivat specifikë të PVEC-së përfshijnë:

- Mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të banorëve gjatë dhe pas emergjencave duke zbatuar masa për evakuimin në kohë, ofrimin e strehimit emergjent dhe ndihmës mjekësore.
- Minimizimin e dëmeve ndaj pronës, infrastrukturës, trashëgimisë kulturore, gjësë së gjallë, komuniteteve dhe mjedisit.
- Identifikimin dhe vlerësimin e risqeve dhe dobësive të mundshme brenda komunitetit për të informuar qytetarët mbi aktivitetet e *Gatishmërisë* dhe *Përgjigjes*.
- Zhvillimin e moduleve dhe programeve të trajnimit dhe të stërvitjeve për aktorët vendorë përgjegjës për emergjencat dhe komunitetin e gjerë.
- Krijimin e kanaleve të qarta të komunikimit për shpërndarjen e informacionit para, gjatë dhe pas një emergjence për të siguruar që banorët të dinë se çfarë veprimesh duhet të ndërmerren.
- Përcaktimin e roleve, detyrave dhe përgjegjësive të të gjitha institucioneve shtetërore dhe jo-shtetërore, subjekteve private, organizatave jo-fitimprurëse (OJF) dhe komunitetit para, gjatë dhe pas një emergjence.
- Garantimin e menaxhimit dhe shpërndarjes efektive të burimeve përfshirë personelin, pajisjet dhe furnizimet, për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive emergjencave.
- Nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet strukturave të qeverisjes vendore, OJF-ve dhe grupeve të komunitetit për të rritur përpjekjet për t'iu përgjigjur emergjencave.
- Rritjen e ndërgjegjësimit të publikut për gatishmërinë ndaj emergjencave civile dhe për veprimet që duhen ndërmarrë sipas llojeve të ndryshme të emergjencave civile përmes programeve dhe fushatave informuese.
- Garantimin e mos-ndërprerjes së shërbimeve dhe funksioneve thelbësore komunitare ose garantimin e rikthimit në gjendje funksionale të tyre sa më shpejt gjatë dhe pas një emergjence.
- Ndërmarrjen e vlerësimeve pas emergjencave dhe stërvitjeve për të identifikuar mësimet e nxjerra dhe për të bërë përmirësimet e nevojshme në planin vendor për emergjencat civile, si dhe në menaxhimin e emergjencave në të ardhmen.

“Plani Vendor për Emergjencat Civile” bazohet në risqet nga rreziqet kryesore të evidentuara në dokumentin “Vlerësimi i riskut nga fatkeqësitë në nivel vendor”, të miratuar me vendimin nr.30, datë 01.04.2025, të Këshillit të Bashkiak, si më poshtë:



- 1) Përmblytjet nga lumenjtë dhe çarjet e digave;
- 2) Aksidentet teknologjike;
- 3) Sëmundjet infektive;
- 4) Rrëshqitjet e tokës, shkëmbinjve dhe ortekët;
- 5) Tërmetet;
- 6) Zjarret masive.

Argumentimi i projektaktit lidhur me përparësitë

PVEC, do të ketë një ndikim të rëndësishëm në sistemi e mbrojtjes civile, duke shërbyer, ndër të tjera, si një dokument orientues për planet e tjera për emergjencat civile të cilat janë ato të:

- 1) Në nivel vendor ku bashkia harton, miraton dhe përditëson planin vendor për emergjencat civile dhe ia dërgojnë AKMC-së dhe prefektit të qarkut, për qëllime analizimi dhe planifikimi.
- 2) Të institucioneve shtetërore në sektorët e shëndetësisë, të arsimit, policisë, mjedisit dhe turizmit, plani i të cilave duhet të jetë harmonizuar me planin vendor për emergjencat civile dhe me dokumentin e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë të bashkisë
- 3) Të subjekteve private kur ato përdorin, dhe magazinojnë materiale të rrezikshme, karburante dhe derivate të tyre, të cilat hartojnë dhe përditësojnë plane të brendshme për emergjencat civile, të harmonizuara me planin për emergjencat civile të bashkisë.
- 4) Të subjekteve private kur ato ushtrojnë aktivitetin e tyre në fondin pyjor e kullosor në territorin e bashkisë, të cilat janë të detyruara të mbrojnë këto sipërfaqe nga zjarret, duke hartuar dhe përditësuar plane për mbrojtjen e këtyre sipërfaqeve nga zjarret, të harmonizuara me planin për emergjencat civile të bashkisë

Përmbledhje shpjeguese përmbajtjes së projektaktit

PVEC të Bashkisë Përmet përmbledh informacione dhe tregon rolet e drejtuesve të përfshirë në të gjitha fazat operacionale të menaxhimit të situatave emergjente, bazuar dhe në përvojën e menaxhimit të disa llojeve të fatkeqësive të ndodhura historikisht në territorin e bashkisë

I gjithë dokumenti i PVEC-së është ndarë në planin kryesor dhe në anekset e tij. Plani kryesor ndahet në 9 seksione, 4 nga të cilët janë fazat e menaxhimit të emergjencave civile, si më poshtë:

1. Kuadri ligjor strategjik kombëtar dhe vendor

1.1 Kuadri kombëtar dhe vendor

1.2 Bashkia Përmet: Kuadri institucional dhe dokumentet strategjike për mbrojtjen civile

1.3 Qëllimi dhe objektivat përgjithshme të PVEC të Bashkisë Përmet

2. Parimet e funksionimit të PVEC

2.1 Parashikueshmëria dhe gatishmëria

2.2 Vendimarrja, lidhshëria dhe pronësia



2.3 Informacioni

2.4 Integrimi dhe bashkëpunimi me grupet e interesit

2.5 Përshtatja e Kuadrit Sendai, OZHQ-ve dhe ndryshimeve klimatike

3. Sistemi i mbrojtjes civile në nivel qendror, nivel qarkudhe në nivel vendor

3.1 Institucionet dhe Strukturat Qendrore të Mbrojtjes Civile

3.2 Institucionet dhe Strukturat Vendore të MC

3.3 Financimi i sistemit të mbrojtjes civile në nivel bashkie

4. Parandalimi/Lehtësimi

Parandalimi përfshin aktivitetet dhe masat për shmangien e plotë të risqeve të fatkeqësive çkzistuese dhe atyre të reja.

Lehtësimi është zvogëlimi ose kufizimi i ndikimeve negative të rreziqeve e fatkeqësive të lidhura me to.

Në fillim përshkruhen aktivitetet që i përkasin fazës së parandalimit/lehtësimit.

4.1 Strukturat dhe institucionet përgjegjësitë e tyre për parandalimin/lehtësimin në nivel e bashkie..

5. Gatishmëria

Objektivi kryesor i fazës së gatishmërisë është të evitohet humbjet e jetës dhe të pasurive si pasojë e kërcënimeve dhe emergjencave. Elementet kyçe të gatishmërisë janë ngritja dhe fuqizimi i kapaciteteve të sistemit të mbrojtjes civile dhe komunitetit për të parashikuar, për të përballuar dhe për t'u rimëkëmbur nga ndikimet negative të rreziqeve dhe fatkeqësive të mundshme me efekt zinxhir (mund të përkufizohet si aftësi ripërtëritëse).

5.1 Analiza Riskut për Bashkinë Përmet

5.2 Informimi dhe ndërgjegjësimi publik

5.3 Masat e gatishmërisë

5.4 Qendrat e Koordinimit dhe zonat e paracaktuara për evakuim dhe përdorimin e tyre për aktivitete në funksion të përgjigjes në raste të emergjencave civile

Sikurse edhe në fazën e parandalimit/lehtësimit, edhe në fazën e gatishmërisë përfshihen tabela të detajuara me rolet dhe përgjegjësitë në fazën e gatishmërisë

6. Përgjigja

Në kuptimin e këtij kapitulli, emergjenca të shkallës më të ulët do të quhen ato emergjenca që, sipas ligjit 45/2019, emërtohen emergjenca civile vendore, si edhe emergjenca civile rajonale, por që mund të kërkojnë edhe aktivizimin e disa kapaciteteve operacionale shtesë të institucioneve dhe strukturave qendrore.

Emergjenca të shkallës më të lartë do të quhen emergjencat civile që, sipas ligjit 45/2019, emërtohen emergjenca civile kombëtare dhe për të cilat shpallet ose jo gjendja e fatkeqësisë natyrore.

6.1 Qëllimet kryesore të përgjigjes.

6.2 Aktivizimi i përgjigjes në bashkinë Përmet

6.3 Aktivitetet e bashkisë në fazën e përgjigjes

6.4 Përgjegjësitë e strukturave dhe institucioneve për përgjigjen në nivel bashkie

6.5 Funkcionet e Përgjigjes

7. Rimëkëmbja.

Faza e *Rimëkëmbjes* pason atë të përgjigjes emergjente dhe luan një rol kyç në kthimin e komunitetit drejt normalitetit. Suksesi i kësaj faze varet nga vazhdimësia dhe integrimi i saj me fazat e parandalimit dhe gatishmërisë. Për Bashkinë Përmet, nevoja për t'u mbështetur në Planin Vendor për Emergjencat Civile (PVEC) është thelbësore në këtë periudhë.

Një komponent kyç i rimëkëmbjes është planifikimi i zonave të emergjencës, duke përfshirë:

- ➔ Zonat e dedikuara për vendosjen e qendrave të pritjes dhe akomodimit emergjent të Mbrojtjes Civile (MC).
- ➔ Strukturat e mbuluara për strehimin e përkohshëm të popullsisë.

Këto hapësira duhet të jenë të mbrojtura nga çdo lloj rreziku, duke siguruar përdorimin e tyre pa kufizime gjatë emergjencave.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm është menaxhimi i mbetjeve dhe rrënojave, i cili kërkon planifikim të saktë për të shmangur ndikimet negative mjedisore dhe shëndetësore.

Në aspektin programor, faza e rimëkëmbjes në nivel bashkie është në përputhje me parimet që përmban PKEC, i cili parashikon identifikimin e masave të rimëkëmbjes afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata.

7.1 Parimet e Rimëkëmbjes dhe zbatimi i tyre në bashkinë Përmet

7.2 Aktivitetet afatshkurtra

7.3 Aktivitetet afatmesme

7.4 Aktivitetet afatgjata

7.5 Roli i institucioneve, strukturave dhe aktorëve të tjerë institucionalë gjatë

rimëkëmbjes

8. Skenarët

8.1 Skenari i riskut nga Përmytjet

8.2 Skenari i Riskut të Zjarreve në Pyje

9. Referenca

ANEKSE:

Aneks 1: Zonat e Emergjencës

Aneks 2: Raportimi Fillestar i Emergjencës

Aneks 3: Formate orientuese për komunikimin me publikun, sipas etapave

Aneks 4: Tabela e kapaciteteve njerëzore dhe logjistike.

Aneksi6: Lista me pikat e kontaktit

Aneksi7: Tabela e bashkërendimit të aktiviteteve / funksioneve në përgjigje të emergjencave

Aneksi8: Komisioni i Mbrojtjes Civile Bashkia dhe rregullorja e funksionimit të komisionit të mbrojtjes civile të bashkisë Përmet

Mirëmbajtja, rishikimi e përditësimi i planit:

PVEC-ja është një dokument që do të rishikohet së paku një herë në 3 vjet për të vlerësuar përputhshmërinë e tij me kushtet ekzistuese dhe të reja, si dhe ato në zhvillim, si dhe me përvojën e fituar nga përdorimi i tij.

Rishikimi, përditësimi dhe mirëmbajtja e planit do të bëhet duke ju referuar kuadrit ligjor të përcaktuar si dhe gjatë përballjes me fatkeqësitë natyrore që mund të prekin territorin e bashkisë Përmet

Në ligjin Nr 45/2019 “ për “Mbrojtjen Civile” është përcaktuar se plani vendor për emergjencat civile, miratohet me vendim të këshillit bashkiak.

Me konfirmimin e bazueshmërisë ligjore nga prefekti qarkut, plani vendor për emergjencat civile do ti dërgohet Agjensisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për qëllime analizimi dhe planifikimi
Për të gjitha arsyet e trajtuara mësipër, propozojmë:

Miratimin e projektvendimit të dokumentit “ Plani Vendor për Emergjencat Civile” 2025 – 2028 të bashkisë Përmet

Përgatiti Relacionin Shpjegues për dokumentin

“ Plani Vendor për Emergjencat Civile”

Kryetari/Grupit të Punës

Florant HASANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

P/VENDIM

Nr _____ Prot

Data _____ .2025

Për

MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT REZERVË PËR DHËNIE NDIHME
FINANCIARE

Bazuar në Ligjin 139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Ligjin Nr. 68 /2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjin 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjin Nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, Ligji Nr.115/2024 "Për Buxhetin e vitit 2025", Vendimi i KB Nr.107 datë 18.12.2024 "Për Buxhetin e Bashkisë Përmet viti 2025" dhe përcaktimin e numrit të punonjësve të bashkisë dhe institucioneve në varësi të saj", Këshilli Bashkiak me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

VENDOSI

1. Të miratojë përdorimin e fondit rezervë për shpenzime buxhetore të paplanifikuara (për dhënie ndihme financiare) në masën 30.000 (tridhjetë mijë) lekë. për sa më poshtë vijon:

1. Altin Cenko në shumën 30.000 (tridhjetë mijë) lekë
2. Miratimin e transferimit buxhetor si më poshtë

Pakësim në strukturën buxhetore :

GR 00,TIT AF135,KAP 01,ART 609,Kod Produkti V494AAA në shumën 30.000 lekë
Shtesa në strukturën buxhetore :

GR 00,TIT AF135,KAP 01,ART 609,Kod Produkti V494AAA në shumën 30.000 lekë

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Buxhet-Financës dhe Tatim –Taksa/Spektori i Buxhet Financës.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETAR I BASHKISË

Alma HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Përmet, më 13.10.2025

RELACION

DREJTUAR

KËSHILLIT BASHKIAK

Shtetasi Altin Cenko banues në Përmet ka bërë kërkesë pranë bashkisë me Nr.3283 Prot datë 07.10.2025 për tu ndimuar financiarisht nga bashkia pasi ndodhet në vështirësi të mëdha ekonomike për të përballuar shpenzimet e varrimit të babait të tij.

Bazuar në Ligjin 139/2015 datë 17.12.2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore ”, Ligjin Nr. 68 /2017 “ Për financat e vetëqeverisjes vendore ”, Ligjin 9936 datë 26.06.2008 “ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë “i ndryshuar, Ligjin Nr.10296 datë 08.07.2010 “ Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Ligji Nr.115/2024 “Për Buxhetin e vitit 2025”, VKB Nr.107 datë 18.12.2024 “ Për miratimin e buxhetit të bashkisë për vitin 2025 dhe përcaktimin e numrit të punonjësve të bashkisë dhe institucioneve në varësi të saj, kërkojmë që :

- 1- Altin Cenko të ndimohet përkatësisht në shumën 30.000 (tridhjetë mijë) lekë.

Bashkengjitur i gjithë dokumentacioni përkatës.

Drejtori Shërbimit Social

Arjana PAPAPANO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

PROJEKT VENDIM

Nr. _____ datë ____ . ____ .2025

PËR

**NJË NDRYSHIM NË VKB NR 107 DATË 18.12.2024 “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT
TË VITIT 2025 DHE NUMRIN E PËRGJITHSHËM TË PUNONJËSVE TË BASHKISË,
NJËSIVE ADMINISTRATIVE DHE INSTITUCIONEVE NË VARËSI TË SAJ,I
NDRYSHUAR**

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 54 “Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak”, pika ç, VKM nr.177 datë 08.03.2017” Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve civil e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore”, VKM nr 241 datë 20.04.2023” Per trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të tjerë jomësimore , ne arsimin parauniversitar” të ndryshuar, VKM nr 425 date 26.06.2024 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike ,të ndryshua , VKM nr 113 datë 01.03.2023 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, referuar shkresës nr.14488 prot, datë 29.10.2024 për transfertën e pakushtëzuar për vitin 2025, si dhe shkresës me nr 3396 prot, datë 14.10.2025 të paraqitur nga Kujdestarja e konviktit, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak

VENDOSI:

1. Të bëhen ndryshimet buxhetore si më poshtë:

1. Të pakësohen shpenzimet buxhetore në strukturën:

Në lekë

Strukturat	Programet	Kod Produkti	Kap	600 paga	601 sigurime	Pershkrim
1110	AA135	VIII1AAA	01	380000	64000	Paga, sigurime për punonjësit

2.Të shtohen shpenzimet buxhetore në strukturat :

Në lekë

Strukturat	Programet	Kod Produkti	Kap	600 paga	601 sigurime	Përshkrim
10430	AC135	V043AAA	01	290000	50.000	Paga,sigurime për punonjësit
9120	AC135	V912AAA	01	90000	14000	Paga,sigurime për punonjësit

II.Të miratojë ndryshimin e numrit të punonjësve të Bashkisë Përmet,Njësive Administrative (pa numrin e punonjësve për funksionet e deleguara)nga 234 në 236 punonjës .

III.Efektet financiare të pikës I të këtij vendimi shtrihen nga 01.10.2025 deri në 31.12.2025. Ndërsa për pikat e tjera të tij efektet shtrihen nga 01.11.2025 deri në 31.12.2025.

IV. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETAR I BASHKISË
ALMA HOXHA

Handwritten signature of Alma Hoxha





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET**

RELACION

PËR

**NJË NDRYSHIM NË VKB NR 107 DATË 18.12.2024 "PËR MIRATIMIN E BUXHETIT
TË VITIT 2025 DHE NUMRIN E PËRGJITHSHËM TË PUNONJËSVE TË BASHKISË,
NJËSIVE ADMINISTRATIVE DHE INSTITUCIONEVE NË VARËSI TË SAJ,
NDRYSHUAR**

Bazuar në Ligjin Nr .139/2015 datë 17.12.2015 " Për vetëqeverisjen vendore " , neni 54 "Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak" ,pika ç,VKM nr.177 datë 08.03.2017" Për klasifikimin e funksioneve,grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve civil e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore", VKM nr 241 datë 20.04.2023"Per trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të tjerë jomësimore , ne arsimin parauniversitar" të ndryshuar,VKM nr 425 date 26.06.2024"Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike ,të ndryshuar,VKM nr 113 datë 01.03.2023"Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi",referuar shkresës nr.14488 prot, datë 29.10.2024 për transfertën e pakushtëzuar për vitin 2025, si dhe shkresës me nr 3396 prot,datë 14.10.2025 të paraqitur nga Kujdestarja e konviktit.

Sipas informacionit të paraqitur konvikti aktualisht nuk frekuentohet nga asnjë nxënës .

Pas rishikimit të strukturës ,me Vendim të Kryetarit të Bashkisë nr 436 date 20.10.2025, 4 pozicione u sistemuuan në vendet vakante dhe kemi nevojë për shtimin e 2 pozicioneve të reja.

Mendojmë që Kuzhina e konviktit të kalojë në funksion të kopshtit me drekë dhe të Qendrës së të moshuarve.në momentin e lidhjes së kontratës me operatorët fitues.(Procedurë e zhvilluar dhe finalizuar nga Operatori i Blerjeve të Përqëndruara) dhe këto 2 pozicione të jenë Kuzhinieri dhe Ndihmës kuzhinieri në Sektorin e Përfshirjes Sociale .

Fondet e miratuara nga transfertat specifike për Konviktin do të mbeten të paprekura për periudhën në vijim.

Për sa më sipër i propozojmë Këshillit Bashkiak :

1. Të bëhen ndryshimet buxhetore si më poshtë:
1. Të pakësohen shpenzimet buxhetore në strukturën:



Në lekë

Strukturat	Programet	Kod Produkti	Kap	600 paga	601 sigurime	Pershkrim
Aparat	AA135	VIII AAA	01	380000	64000	Paga, sigurime për punonjësit

2. Të shtohen shpenzimet buxhetore në strukturën :

Në lekë

Strukturat	Programet	Kod Produkti	Kap	600 paga	601 sigurime	Pershkrim
Përfshirja Sociale	AC135	V043 AAA	01	290000	50.000	Paga, sigurime për punonjësit
Arsimi parashkollor	AC135	V912 AAA	01	90000	14000	Paga, sigurime për punonjësit

Fondet për mbulimin e këtyre shpenzimeve për paga dhe sigurime do të përballohen nga ndryshimi i sipërcituar si dhe nga vakancat e krijuara gjatë vitit.

II . Të miratojë ndryshimin e numrit të punonjësve të Bashkisë Përmet, Njësive Administrative (pa numrin e punonjësve për funksionet e deleguara) nga 234 në 236 punonjës .

Konceptuan: *Zafer Jona*

Miratoi: *Vangjela Nago*
Oliver Krew



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL
ARSIM,KULTURË,SPORT

Nr. _____ prot.

Përmet më _____. _____. 2025

P/VENDIM

Për miratimin e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmës ekonomike, deri në 6% .

Në mbështetje të ligjit nr.139 datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore”i ndryshuar me ligjin nr.38/2019 datë 20.06.2019 ligji nr.9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, ligji nr.9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmen dhe shërbimet shoqërore “ i ndryshuar me VKM nr.868 dt.29.12.2021 “Per disa ndryshime ne Vendimin 597 dt.04.09.2019 të K.M.”Për percaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe mases mujore te perfitimit te ndihmës ekonomike dhe perdorimit te fondit shtese,mbi fondin e kushtezuar per ndihmen ekonomike,VKM nr.85 dt.10.02.2021,nr.617,date 22.09.2022 i perditësuar: Vendimin e Keshillit Bashkiak Permet me fondet e Buxhetit Vendor.VKB nr.107 date 18.12.2024 “Per miratimin e buxhetit te bashkise per vitin 2025 dhe percaktimin e numrit te punojseve të bashkise, institucioneve në varesi të saj”. Keshilli Bashkiak,me propozim të Kryetares së Bashkisë:

VENDOSI

- 1.Të perfitojnë ndihme ekonomike per Muajn Shtator 2025, 6 familje me një fond prej 21.184 lekë.
2. Familjet që perfitojne jane si më poshtë:

Nr	Emri, Atesia, Mbiemri	Bashkeshortja/i	N.ant.	Shuma
1	Ylli Guçe Pelushaj	Zylkade Qerim Pelushaj	2	3.703
2	Roland Petraq Jorgji	Divorcuar	1	2.178
3	Lame Enver Ferati	Silvana Kujtim Ferati	3	5.227
4	Mimoza Skënder Gjoka	Divorcuar	1	2.178
5	Lefteri Mihal Tyto	Divorcuar	1	5.720
6	Flavia Musa Pelushaj	Beqare	1	2.178
	SHUMA			21.184

- 3..Ngarkohen per zbatimin e ketij vendimi sektori buxhet-finance dhe zyra e ndihmes ekonomike.

KRYETAR I BASHKISË
Alma HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr. _____ prot.

Përmet më _____. _____. 2025

RELACION

**PËR MIRATIMIN E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLLOK NDIHMËS
EKONOMIKE, DERI NË 6% .**

Mbështetur në Ligjin Nr.139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar me ligjin nr.38/2019 datë 20.06.2019 ligji Nr.9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”Ligjit 935 datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”I ndryshuar me VKM Nr.955 datë 07.12.2016(kreu II pika 13)dhe udhëzimi nr.5 datë 17.02.2017 pika 2 i Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë.Për përcaktimin kriterëve,dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike si dhe VKM nr.85 dat 10.02.2021,nr.868,datë 29.12.2021;n timer.617,datë 22.09.2022 i përditësuar Vendimi i,Këshillit Bashkiak Përmet me fonde të Buxhetit Vendor Nr.107 datë 18.02.2024”Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë për vitin 2025 dhe përcaktimin e numrit të punonjësve të Bashkisë,institucioneve në varësi të saj “Këshilli Bashkiak ka të drejtë të trajtojë me ndihmë ekonomike familjet aplikuese që nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit,deri 6% të bllok ndihmës ekonomike të muajit.Shtator 2025 me Vendim të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Socail Gjirokastër.Nr.10/2022 datë 27/10/2022 për dhënien e NE për periudhën 01-30-2025 Për Bashkinë Përmet.(Sipas vendimit të Muajit Shtator 2025).

Për sa më sipër vlера e fondit të kushtëzuar (bllok ndihma ekonomike) për Muajin Shtator 2025

është 50 familje me,Shumën prej 376.119 lekë dhe për tu trajtuar familje me ndihmë ekonomike janë në dispozicion 6% e këtij fondi ose 22.567 lekë,për Muajin Shtator 2025.

Mbështetur në të dhënat për dhënien e Ndihmës Ekonomike për periudhën 1-30 Shtator 2025 kanë aplikuar 5 familje asedhenjë familje nuk ka dale fituese 50 janë përfituese në skemën e Ndihmës Ekonomike.

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i aplikuesve që nuk kane marë pikët e mjaftueshme për periudhën 01 Shtator deri më datën 30 nga vlersimi I SH.S.SH rekumandojmë:

Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar prej 6%,6 familje me një vlerë 21.184 lekë,nga ku fondi 6% në total sipas vendimit është në Shumën 22.567 diferanca prej 1.383 lekë do të mbetet e papërdorur për muajin Shtator.Trajtohen dy individë me statusin jetimë. me 20.100 lekë,nga 10.050 lekë sejcili.

Specialisti i NE

Jurigen SIMONI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
DREJTORIA E SHËRBMIT SOCIAL
ARSIM,KULTURË,SPORT

Nr. _____ prot.

Përmet më ____ . ____ .2025

P/VENDIM

**PËR MIRATIMIN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR FAMILJET NË NEVOJË MUAJI
TETOR 2025**

Në mbështetje të ligjit nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore" i ndryshuar me ligjin nr.38/2019 datë 20.06.2019 ligji nr.9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar, ligji nr.9355, date 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore "i ndryshuar, VKM nr.869 datë 29.12.2021 për disa ndryshime në VKM nr.597 datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë, mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike,VKM Nr 868 date 29.12.2021 "Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike",VKM Nr617 datë 22.09.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.597,date 4.9.2019 të Këshillit të Ministrave,"Për përcaktimin e procedurave,dokumentacionit dhe masës mujore,të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike". VKB nr.107 datë 18.12.2024 "Per miratimin e buxhetit te bashkise per vitin 2025 dhe përcaktimin e numrit te punojseve te bashkise, institucioneve ne varesi te saj "Keshilli Bashkiak me propozim te Kryetarit te Bashkise:

VENDOSI

1.Të përfitojnë ndihme ekonomike për Muajn TETOR 2025, 33 familje me një fond **123.500 lekë**.

2.Fondet të përballohen nga struktura :

1.Gr.00.Tit.AC135.Kap.05.Art.606.Kod produkti V043AAD per shumen 123.500 lekë

3. Familjet që përfitojnë janë si më poshtë:

Nr	Emri, Atesia, Mbiemri	Bashkeshortja/i	N.ant.	Shuma/leke
1	Ziso Apostol Kristo	Valentina Polikron Kristo	3	4200
2	Xhilda Xhemal Selimllari	Xhilda Xhemal Selimllari	2	3600
3	Mitro Gani Zeqiri	Lefteri Rrapi Zeqiri	4	4700
4	Syrja Mehmet Hoxha	Beqar	1	3200
5	Drita Irakli Kosta	Divorcuar	2	3600
6	Lefteri Polikron Proko	E ve	1	3200
7	Andon Dhimitraq Kukureci	I ve	2	3600
8	Aferdita Nuredin Lahe	Beqare	1	3200
9	Arben Thoma Teka	Mirela Xheli Teka	6	5400
10	Viktor Josif Proko	Divorcuar	1	3200
11	Dhimo Naun Dimçi	Lindita Hysen Dimçi	3	4200
12	Vera Thanasi Nage	E ve	2	3600

13	Leonart Petro Markaj	Kristina Petraq Markaj	3	4200
14	Thoma Aristidh Ilia	Maria Nuredin Ilia	4	4700
15	Xhensila Maksim Jahjaj	Beqare me Femijë	2	3600
16	Violeta Guce Pelushi	Beqare	1	3200
17	Engjellushe Manxho Canollari	E ve	1	3200
18	Rivelino Fatmir Doko	Hurma Leonidha Doko	4	4700
19	Bajame Fari Hysenshahaj	E ve	1	3200
20	Lida Koco Thomollari	Divorcuar	1	3200
21	Vasilika Bedri Malka	E ve	2	3600
22	Ilir Sali Jashari	Beqar	1	3200
23	Vitori Llazo Caci	Beqare	2	3600
24	Luam Ferit Zeneli	Gezime Tafil Zeneli	4	4700
25	Ilber Kudret Dalipaj	Divorcuar	1	3200
26	Kastriot Kristo Koto	Kastriot Kristo Koto	3	4200
27	Kastriot Astrit Male	Divorcuar	1	3200
28	Vangjush Thanas Mamillo	Gentiana Seit Mamillo	3	4200
29	Bari Avni Zaimi	Valbona Zenel Zaimi	2	3600
30	Kadri Petrit Maska	Beqar	1	3200
31	Dashnor Guçe Pelushaj	Vezire Ali Pelushaj	4	4700
32	Klodiana Kristofor Peçi	Divorcuar	1	3200
33	Lulëzim Barjam Beqari	Divorcuar	1	3200
	SHUMA			123.500

4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Buxhet-Finances dhe Tatim –Taksa/Spektori i Buxhet Financës.

5. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë mbas shpalljes.

KRYETAR I BASHKISË

Alma HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA E PËRMET

Nr. _____ prot.

Përmet më ____ . ____ . 2025

RELACION

**PËR MIRATIMIN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR FAMILJET NË NEVOJË MUAJI
TETOR 2025**

Në mbështetje të ligjit nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore" i ndryshuar me ligjin nr.38/2019 datë 20.06.2019 ligji nr.9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligji nr.9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" i ndryshuar, VKM nr.869 datë 29.12.2021 për disa ndryshime në VKM nr.597 datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë, mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike, VKM Nr 868 datë 29.12.2021 "Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike", VKM Nr.617 datë 22.09.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.597, datë 4.9.2019 të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore, të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike". VKB nr.107 datë 18.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të bashkisë për vitin 2025 dhe përcaktimin e numrit të punojësve të bashkisë, institucioneve në varësi të saj. Familje të cilat janë përfituese në fondin e bashkisë janë ato familje të cilat mbasi kanë bërë aplikimin në Sistemin e Ndihmës ekonomike, rekomandimin në fondin 6% nuk janë fituese. Dhe nga vizitat e kryera në familje nga Administratorët shoqëror duke parë gjëndjen ekonomike të këtyre familjeve të cilat janë në gjëndje të dobët ekonomike u arsyetua që të përfshihen në fondin e familjeve në nevojë.

Përsa më sipër rekomandojmë të ndihmohen për muajin Tetor 33 familje me një vlerë prej 123.500 lekë.

Specialisti i NE

Jurigen SIMONI

